




ELEMENTËT NDËRSEKTORIALË

Të gjitha aktivitetet në kuadër të Instrumentit Horizontal do të kryhen me një qasje ndaj të drejtave të njeriut, duke përfshirë parimet e barazisë gjinore - në pajtim me Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Integrimin Gjinor - dhe mosdiskriminimin, pjesëmarrjes së barabartë dhe përfshirëse, duke u fokusuar në grupet e rrezikuara dhe minoritetet. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile (OJQ-të) do të sigurohet në pajtim me Udhëzimet e Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në aktivitetete bashkëpunimit Këshillit të Evropës dhe në përputhje me Udhëzimet e Komisionit Evropian për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet në zgjerim.

MË SHUMË INFORMACION

- **Website**
<http://horizontal-facility-eu.coe.int>
- **Facebook**
jp.horizontal.facility
- **Twitter**
[@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)
- **Kontakt**
Zyra e Këshillit të Evropës në Beograd
Blue Center, Block 26, Building B
Spanskih Boraca 3
11070 Beograd
Serbi
Tel: +381 11 71 555 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

AL



INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e të drejtave të njeriut në kontinent. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtarë të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik dhe politik mes 28 vendeve demokratike Europeane. Qëllimet e tij janë paqja, prosperiteti dhe liria për 500 milionë qytetarë të tij- në një botë më të drejtë dhe më të sigurtë. Me qëllim realizimin e këtyre objektivave, vendet e BE-së kanë ngritur organe për të drejtuar BE-në dhe për të miratuar legjislacionin e tij. Ato më kryesore janë Parlamenti Evropian (që përfaqëson popujt e Evropës), Këshilli i Bashkimit Evropian (që përfaqëson qeveritë kombëtare) dhe Komisioni Evropian (që përfaqëson interesat e përbashkëta të BE-së).

<http://europa.eu>

Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar
Sigurimi i drejtësisë
Lufta kundër diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël
Mekanizmi për Koordinime Ekspertizës

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

Funded by the European Union and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented by the Council of Europe

Funded by the European Union and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented by the Council of Europe



■ Më 11 prill 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, Thorbjørn Jagland, dhe Komisioneri i Bashkimit Evropian për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerimin, Johannes Hahn, njoftuan mbi një nismë të bashkëpunimit të dy organizatave që synon mbështetjen e Evropës Juglindore dhe Turqisë në pajtueshmërinë e tyre me standardet evropiane. Nisma quhet Instrumenti Horizontal i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (Instrumenti Horizontal).

FOKUSI DHE FUSHËVEPRIMI I INSTRUMENTIT HORIZONTAL

■ Instrumenti Horizontal është një nismë trevjeçare (maj 2016-prill 2019) i fokusuar në tri tema:


- ▶ sigurimi i drejtësisë,
- ▶ Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar;
- ▶ Lufta kundër diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël

■ Iniciativa ka një buxhet prej €25 milionë¹.

■ Përmes Instrumentit Horizontal, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës do të ndihmojnë përfituesit në Evropën Jug-Lindore në pajtueshmërinë e tyre me standardet e Këshillit të Evropës dhe me *acquis* të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të zgjerimit. Instrumenti Horizontal mbështetet në metodat unike të punës të Këshillit të Evropës, ku aktivitetet teknike të bashkëpunimit, të përshtatura, janë bazuar në përfundimet dhe rekomandimet e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës të cilat kanë nxjerrë në pah fushat ku përmirësimet në legjislaionin dhe politikat e përfituesve janë të nevojshme për të respektuar traktatet dhe standardet e tjera të organizatës.

¹ Komisioni Evropian do të sigurojë €20 milion dhe Këshilli i Evropës €5 milion për të mbështetur iniciativën.

Trekëndëshi Strategjik i Këshillit të Evropës



VENDET QË PËRFITOJNË NGA INSTRUMENTI HORIZONTAL

■ Vendet që përfitojnë bashkëpunimin teknik përmes Instrumentit Horizontal janë Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Kosova*, Mali i Zi dhe Serbia. Përfshirja e Turqisë do të jetë e kufizuar në marrjen e analize/këshillave ligjore përmes Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës dhe për aktivitete të mundshme rajonale.

ORGANIZIMI I INSTRUMENTIT HORIZONTAL

■ Instrumenti Horizontal do të ndjekë një qasje plotësuese të dyfishtë: 1) bashkëpunim teknik në formën e këshillave, zhvillimi i kapaciteteve dhe formave të tjera të mbështetjes teknike të përshtatura për nevojat e secilit përfitues, për të arritur rritjen e pajtueshmërisë me standardet evropiane dhe 2) Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës, sipas të cilit Këshilli i Evropës siguron ekspertizë legjislativë dhe këshillim mbi politikat në përgjigje të kërkesave nga vendet përfituese mbi tema të mbuluara nga Instrumenti Horizontal dhe për çështje që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe medias, por edhe për çështje të caktuara kushtetuese që bien në kuadër të mandatit të Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (i njohur si Komisioni i Venecias).

* Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opininionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



FUSHAT E NDËRHYRJES

■ Komponentët e ndryshëm do të përpunohen në varësi të nevojave dhe prioritetëve të secilit përfitues.

Sigurimi i drejtësisë

■ Puna në këtë fushë tematike do të përqendrohet në burgje dhe forcat e policisë (përfshirë të drejtat e njeriut gjatë policimit, kujdesi shëndetësor në burgje dhe masat mbrojtëse kundër torturës dhe keqtrajtimeve), në standardet e të drejtave të njeriut në gjyqësor (duke u fokusuar në rritjen e zbatimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), në efikasitetin e sistemit të drejtësisë (me fokus në analizimin e statistikave gjyqësore për të bërë administratat gjyqësore më rentabël) dhe/ose bashkëpunimit ligjor (i cili do të përqendrohet në rritjen e pavarësisë individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe llogari dhënien në sistemin gjyqësor).

Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar

■ Instrumenti Horizontal do të ketë si objektiv luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ku do të përfshihen masa për të trajtuar transparencën e financimit të partive politike, sistemet e deklarimit të pasurisë, vlerësimet kombëtare të rrezikut dhe zhvillimin e kapaciteteve të njësisë të inteligjencës financiare. Përveç kësaj, aktivitetet në disa vende përfituese do të adresojnë në mënyrë specifike korrupsionin në arsim.

Promovimi i anti-diskriminimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grupeve vulnerabël

■ Varësisht nga nevojat dhe prioritetet e përfituesve në fjalë, puna në këtë fushë do të përqendrohet në mbështetjen e institucioneve të Avokatit të Popullit, arsimin gjithëpërfshirës (ku trajtohet racizmi, bullizmi, veçimi dhe ekstremizmi në sistemin arsimor), trajtimin e çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore (me fokus në ndihmën për viktimat e trafikimit), luftën kundër diskriminimit ndaj pakicave kombëtare dhe/ose atë mbi bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor.